

**MARRËVESHJE**  
**E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE**

Date: 22.01.2018

Sot në datën 22.01.2018, në Tiranë, midis shoqërive të mëposhtme:

**Shoqëria "ABCom" Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, e themeluar në përputhje me ligjin shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar në datën 17.04.1998, me nr. Regjistrimi K 11308001 B, me seli në adresën: Rruga "Rreshit Çollaku", nd. 4, h. 2, ap. 8, Njësia Bashkiake nr. 10, Kodi Postar 1001, Tiranë, përfaqësuar nga Administratorët: z. Genti Daci dhe z. Altin Leksani ("Shoqëria Përthithëse"/"ABCom")

Dhe

**Shoqëria "AVision" Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, e themeluar në përputhje me ligjin shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar në datën 07.07.2014, me nr. Regjistrimi L 41907012 K, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr. 8, rruga "Selaudin Bekteshi", Godina nr. 2, (ish-Peliceria), Tiranë, përfaqësuar nga Administratori z. Vladimir Dedolli ("Shoqëria e Përthithur"/"AVision"),

Këtu dhe me poshtë Shoqëria Përthithëse dhe Shoqëria e Përthithur do të referohen bashkërisht si "Palët".

**Neni 1**

**Objekti**

1. Objekt i kësaj Marrëveshjeje Bashkimi me Përthithje, është përfundimi i procedurave ligjore për bashkimin me përthithje të shoqërive "ABCom" Sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë përthithëse dhe "AVision" Sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë së përthithur, nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë së përthithur në favor të shoqërisë përthithëse, siç ato rezultojnë deri në datën e realizimit të përthithjes.

**Neni 2**

**Baza ligjore**

1. Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", konkretisht dispozitat e neneve 215 – 225, Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

### **Neni 3**

#### **Qëllimi i motivuar**

1. Shkurtimi i shpenzimeve, mbrojtja ndaj konkurrencës, përmirësimi i pozitës së shoqërisë në treg, menaxhimi më i mirë i aktivitetit ekonomik dhe financiar, përballimi i konkurrencës në treg dhe për rrjedhojë, rezultat më të mirë në fitimin e shoqërisë.

### **Neni 4**

#### **Marrëveshja e palëve dhe funksionimi procedural i bashkimit me përthithje**

1. Bashkimi me përthithje i shoqërive "ABCom" Sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë përthithëse dhe "AVision" Sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë së përthithur, është një veprim juridik me të cilin shoqëria e përthithur transferon të gjitha aktivitetet dhe pasivitetet e saj, të cilat janë prezantuar në bilancin dhe pasqyrat financiare të shoqërisë, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi deri në momentin e përthithjes, tek shoqëria përthithëse, duke pushuar së ekzistuari në këtë mënyrë shoqëria e përthithur, pa shkuar në likuidim.

2. Palët në këtë Marrëveshje shprehin vullnetin e tyre për pranimin e këtyre procedurave dhe pasojave të tyre.

### **Neni 5**

#### **Raporti i këmbimit të kuotave**

1. Si pasojë e realizimit të procedurës së bashkimit me përthithje të shoqërive në këtë operacion, të drejtat që rrjedhin nga kuotat e shoqërisë përthithëse mbeten të pandryshueshme nga ato të përmendura në Statutin e shoqërisë përthithëse, si shoqëria e cila është njëkohësisht ortakë me 100% të kuotave të shoqërisë së përthithur.

2. ABCom, si shoqëria përthithëse në këtë Marrëveshje Bashkimi me Përthithje dhe njëkohësisht si ortakë i vetëm i shoqërisë së përthithur zotëruese e 100% të kuotave, i ka të përcaktuara në Statutin e saj të drejtat e zotërimit të kuotave, të cilat nuk ndryshojnë edhe pas bashkimit me përthithje të AVision.

### **Neni 6**

#### **Organet administrative, punëmarrësit**

1. Në përfundim të procedurës së bashkimit të shoqërive me përthithje, organi administrativ i shoqërisë do të vijojë të drejtohet nga administratorët e shoqërisë përthithëse, të cilët do të ushtrojnë kompetencat e administrimit sipas ligjit.

2. Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve, mbeten të njëjta, siç ato janë përcaktuar në statutin e shoqërisë përthithëse.

3. Punëmarrësit e shoqërisë së përthithur, me realizimin e bashkimit, do të konsiderohen si punëmarrës të ABCom dhe do të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në Kodin e Punës.

4. Në datën e realizimit të bashkimit me përthithje, çdo kontratë pune e shoqërisë së përthithur "AVision" Sh.p.k. në fuqi, do të transferohet sipas ligjit tek shoqëria përthithëse "ABCom" Sh.p.k., në përputhje me nenin 138 të Kodit të Punës. ABCom do të marrë përsipër të gjitha dhe çdo kontratë pune të punëmarrësve të transferuar, së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre.

## **Neni 7**

### **Garancitë për kreditorët dhe mbrojtja e tyre**

1. Themelore në këtë procedurë bashkimi me përthithje të shoqërive është garantimi i kreditorëve të shoqërive të përfshira në këtë bashkim, sidomos ata të shoqërisë së përthithur, në kushtet kur, pavarësisht humbjes së debitorit fillestar (shoqëria e përthithur), detyrimet e tij sipas ligjit i transferohen në tërësi dhe të pacenuara shoqërisë përthithëse, ashtu siç ato janë bërë të njohura deri në momentin e përthithjes.

2. Shoqëria përthithëse (ABCom) merr përsipër sipas ligjit të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretët, kundrejt të gjithë kreditorëve dhe debitorëve të shoqërisë së përthithur (AVision), duke garantuar kreditorët e shoqërisë së përthithur që mund t'i kundrejtojnë pretendimet e tyre, të rezultuara deri në momentin e përthithjes, ndaj shoqërisë përthithëse.

## **Neni 8**

### **Prishja pa likuidim e shoqërisë së përthithur**

1. Shoqëria e përthithur (AVision), si shoqëri e përthithur nga shoqëria "ABCom" Sh.p.k., në përfundim të këtij procesi do të vlerësohet e prishur pa likuidim, duke kaluar plotësisht trashëgiminë e saj ekonomike, financiare dhe ligjore tek shoqëria përthithëse, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi, në datën e realizimit përfundimtar të operacionit, duke u çregjistruar nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, sipas seksionit V të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", pa kaluar në procesin e likuidimit.

**Neni 9**  
**Mbyllja**

1. Në datën e mbylljes së bashkimit me përthithje palët do të ekzekutojnë dhe dorëzojnë pranë QKR-së, dokumentet e mëposhtme:

- (i) Marrëveshja përfundimtare e Bashkimit me Përthithje;
- (ii) Vendimet e ortakëve të shoqërisë përthithëse dhe asaj të përthithur për miratimin e Marrëveshjes përfundimtare të Bashkimit me Përthithje;
- (iii) Deklarata e dorëheqjes të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë së përthithur;
- (iv) Statuti i ri i shoqërisë përthithëse "ABCom" Sh.p.k., i vlefshëm nga data e mbylljes së bashkimit me përthithje.

**Neni 10**  
**Të ndryshme**


1. Kjo Marrëveshje (bashkë me dokumentet në të cilat ajo referon) përbën marrëveshjen në tërësi të Palëve, duke zëvendësuar dhe pasur përparësi ndaj çdo marrëveshjeje, rregullimi apo ndërmarrjeje të mëparshme të Palëve, në lidhje me këtë çështje.

2. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse realizohet me shkrim dhe nënshkruhet rregullisht nga Palët. Mosmarrëveshjet midis Palëve do të zgjidhen me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet mirëkuptimi, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, në 3 (tre) ekzemplarë originalë, secili prej tyre i nënshkruar rregullisht me vullnetin e lirë të Palëve.

**PALET:**

Shoqëria "ABCom" Sh.p.k.  
Administratorët  
Genti Daci                      Altin Leksani



Shoqëria "AVision" Sh.p.k.  
Administratori  
Vladimir Dedolli

